

## **MEMORANDUMI BASHKËPUNIMI**

### **NDËRMJET**

**Ministri pa resor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i angazhuar për diasporë, Edmond Ademi (në tekstin e mëtejmë: Ministri) dhe Universitetin “Sh. Kirili dhe Metodi” në Shkup, të përfaqësuar nga rektori prof. Dr. Nikolla Jankulovski (në tekstin e mëtejmë: UKIM)**

Duke pasur parasysh nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet ministrit dhe UKIM për çështjet me interes të përbashkët dhe dëshirën për të forcuar dhe rritur një bashkëpunim të tillë, nënshkruesit ranë dakord të bashkëpunojnë si më poshtë:

#### **Neni 1**

Brenda mandateve përkatëse dhe në përputhje me burimet në dispozicion, palët nënshkruese do të punojnë ngushtë së bashku dhe do të zhvillojnë konsultime për çështje me interes të përbashkët.

Palët nënshkruese bien dakord që aktivitetet në lidhje me diasporën do të koordinohen, për aq sa është e mundur, për të arritur bashkëpunimin maksimal dhe kur kërcohët nga interesat e përbashkëta, ku secila palë mund të kërkon bashkëpunim nga tjetra.

Çdo Palë do të përpinqet, për aq sa është e mundur dhe në përputhje me instrumentet dhe vendimet të autoriteteve kompetente, t'i përgjigjet në mënyrë të favorshme këtyre kërkesave për bashkëpunim në përputhje me procedurat e dakorduara reciprokisht.

#### **Neni 2**

Palët nënshkruese bien dakord të shkëmbejnë informacion dhe dokumentacion nga domeni publik deri në një masë të madhe të mundshme për çështje me interes të përbashkët.

Kur është e përshtatshme dhe kur i nënshtrohen kushteve të nevojshme, informacionet dhe dokumentacionet për projekte ose programe konkrete mund të shkëmbehen gjithashtu ndërmjet palëve nënshkruese, në mënyrë që të arrihet një veprim më i mirë plotësues dhe koordinim efektiv ndërmjet palëve nënshkruese.

#### **Neni 3**

Palët nënshkruese bien dakord të marrin në konsideratë fushat e mëposhtme të bashkëpunimit për aktivitete dhe bashkëpunim të ndërsjellë në:

- Mbështetje këshillimore për zhvillimin e politikave dhe dokumenteve strategjike për diasporën;

- Krijimi i qendrës për diasporë dhe migrim në kuadër të UKIM;
- Mbështetje në angazhimin efektiv të diasporës;
- Çështje të tjera të ndërlidhura në koordinim dhe me marrëveshje ndërmjet palëve.

#### **Neni 4**

Palët nënshkruese do të zhvillojnë konsultime të rregullta të ndërsjella për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Memorandum.

Palët nënshkruese mund të lidhin marrëveshje shtesë për qëllime bashkëpunimi dhe koordinimi kur e vlerojnë të nevojshme dhe të përshtatshme.

#### **Neni 5**

Palët nënshkruese mund të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë Memorandum mirëkuptimi.

Pala që kërkon ndryshimin është e detyruar që kërkesën e saj t'ia dorëzoj me shkrim palës tjetër.

Memorandumi mundet ndryshohet dhe/ose shtohet duke lidhur në aneks.

#### **Neni 6**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të Memorandumit do të zgjidhen në mënyrë miqësore ndërmjet palëve nënshkruese.

#### **Neni 7**

Memorandumi lidhet për një periudhë kohore të pacaktuar dhe secila nga palët mund ta ndërpresë atë me njoftim me shkrim.

Memorandumi konsiderohet i përfunduar pas skadimit të 30 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### **Neni 8**

Memorandumi është i përbërë në 4 (katër) kopje identike, nga dy për secilën nga palët. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**Ministër pa resor, i angazhuar  
për diasporë**

**Edmond Ademi**

**Rektori i Universitetin “Sh. Kirili dhe Metodi”  
në Shkup**

**Prof. Dr. Nikola Jankulovski**